



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/1042**

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të; Isa Hasani-kryetar, Vjosa Gradinaj -Mexhuani dhe Vedat Poterqoi- anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik “Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI” Sh.P.K. të datës 22.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 01.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi i master - planit për Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz në Komunën e Skenderajt në Republikën e Kosovës” me numër të prokurimit 207-23-5283-2-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancë pa prezencën e palëve me datë, 09.02.2024, merr këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE “Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë - INSI” Sh.P.K. , kundër, Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi i master - planit për Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz në Komunën e Skenderajt në Republikën e Kosovës” me numër të prokurimit 207-23-5283-2-1-1.

2. Mbetet në fuqi “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” i datës 01.12.2023, Formulari B58 - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1. të dispozitivit.

3. Konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, ndaj operatorit ekonomik ankues, bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi i master -

planit për Komplexin Memorial Adem Jashari në Prekaz në Komunën e Skenderajt në Republikën e Kosovës” me numër të prokurimit 207-23-5283-2-1-1.

Me datë 01.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58. Me datë 06.12.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues.

Me datë 14.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar në tërësi kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues. Me datë 22.12.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/1042.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Në mbështetje të Rregullores 01/2020 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit gjegjësisht nenit 13 Dorëzimi i Ankesave paragrafi 9 i nenit 13 kërkohet që "Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues".

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:*

Pretendimi i parë ankimor: “operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit OE ”Polis”, në kundërshtim me nenin 55.24 të RRUOPP, e ka zbuluar identitetin e vet përmes dokumenteve të paraqitura pranë AK”.

Pretendimi i dytë ankimor: “Propozimi i shifrës [2606] është i mbivlerësuar vis a vis propozimit të shifrës [1111], ndërkohë që ky i fundit është thellësisht i nënvlerësuar për tërësinë e propozimeve që ka bërë Komisioni Vlerësues. Shifra 2606 ka dhënë një propozim të përgjithshëm, sipërfaqësor dhe pa vlera të pashtjelluar. Vetë koncepti është i pa trajtuar dhe i pa artikuluar në dokumentin e propozimit. Koncepti i propozuar nga shifra 2606 është i mangët, steril dhe thjesht një përshkrim sipërfaqësor. Ai nuk është shtjelluar as minimalisht sipas një strukturë të kërkuar pa arritur të ndërtojë vizion, pa përcaktuar qëllime dhe objektiva për zhvillim. Ndërkohë propozimi i shifrës 1111 është i shtjelluar në detaje duke mirë përcaktuar Vizionin për zhvillim, Qëllimet dhe Objektivat specifike me instrumentet përmes së cilëve të realizohen këto objektiva. Përkundër që është kërkuar me detyrë projektuese, kompleksit memorial të propozuar nga shifra 2606, i mungon të kuptuarit e masterplanit i mungojnë vizioni, qëllimet dhe objektivat, si dhe më shumë i mungojnë edhe parimet e kërkuara me detyrë projektuese për projektim, kështu që vlerësimi i tij me poenë maksimal është i çuditshëm kur merren për bazë gjithë këto mungesa”.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli shqyrtues me datë 26.12.2023, ka angazhuar ekspertin shqyrtues ndërsa me datë 27.12.2023, ka angazhuar ekspertin teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 05.01.2024, është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: “eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik i propozojnë Panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK”.

*Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1042, të pretendimeve ankimore të OE ankues, si në vijim;*

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: “Fillimisht konfirmojmë se zbulimi identitetit nga OE:”Polis” është konfirmuar edhe nga vet AK-MKRS përmes vendimit në kërkesës për rishqyrtim. Për më tepër, nga shkresat e lëndës nuk kemi gjetur ndonjë dëshmi se AK-MKRS në çfarëdo faze e kontestuar këtë pretendim të OE ankues. Realisht, duke filluar nga njoftimi mbi vendimin e AK-së i nënshkruar me 01.12.2023, autoriteti kontraktues e ka bërë të ditur se OE ka zbuluar identitetin. Megjithatë kthimi i lëndës në rivlerësim mbi këtë bazë, nuk do të sillte ndryshim në rezultat final për këtë aktivitet të prokurimit, kjo sepse OE “Polis” nuk është OE i rekomanduar për kontratë. Sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 01.12.2023 operatori ekonomik i renditur me më shumti pikë është oferta me kodin 2606, ndërsa OE:”Polis” është renditur i fundit, me më së paku pikë nga të gjithë OE-të pjesëmarrës, dhe ky OE nuk ka bere ankese kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 01.12.2023 që nënkupton se është pajuar me vlerësimin e AK dhe nuk është palë e interesuar për këtë aktivitet prokurimi.

Përderisa OE “Polis” është renditur i fundit me pikë, dhe kemi një OE tjetër i cili ka marr pikët më të larta nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës, i cili po ashtu nuk ka zbuluar identitetin e vet, kthimi i lëndës në rivlerësim vetëm do të shkaktonte vonesa dhe shpenzime shtesë pa ndryshim në rezultat final. Një veprim i tillë konsiderojmë se do ishte në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 të LPP- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, pasi nuk është as ekonomike e as efikase të përsëriten apo zvarriten procedurat të cilat shpien në rezultat të njëjtë. Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimorë dhe kërkesa e OE që lënda të kthehet në rivlerësim për arsye se njëri nga OE-të (i renditur i fundit me pikë) ka zbuluar identitetin e vet është i pabazuar”.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor, në raportin e ekspertizës janë paraqitur konstatimet si në vijim: “Si ekspert teknik fillimisht konsideroj se është me rendësi të potencohet fakti se vlerësimi i projekteve është bere nga një komision profesional pesë anëtarësh dhe një monitorues. Në kuadër të këtij komisioni ka pasur arkitekt nga MKRS dhe MMPHI, inxhinier i ndërtimtarisë dhe antropolog nga Universiteti i Prishtinës, arkitekt nga Asociacioni i Arkitekteve te Kosovës dhe zyrtar i prokurimit nga MKRS si monitorues i procesit të vlerësimit. Për shqyrtimin e kësaj lënde jam mundur që të jap maksimumin në vlerësimin e drejtë, etik dhe profesional duke marre parasysh rëndësinë e aktivitetit. Në bazë të shqyrtimit të projekteve që kanë aplikuar në këtë konkurs projektimi, shihet se projekti i përzgjedhur nga Juria profesionale nga AK me shifrën 2606, është dukshëm me meritore krahasuar me projektet tjera konkurrenente, andaj pajtohem me vlerësimin e jurisë profesionale.

Koncepti i projektit të prezantuar me shifrën 2606, është me vizionar, me gjithëpërfshirës, me integruar, duke inkorporuar brenda kompleksit faktorët natyror dhe njerëzor, peizazhin kulturor, perceptimin e vizitorit, ndjenjën e krenarisë për të kaluarën, si dhe për avancimin kulturor në të ardhmen. Sa i përket trajtimit të infrastrukturës fizike në projektet e prezantuara (terrenet sportive, rrugët dhe parkingjet) të projektit me shifrën 2606, janë vendosur në periferi, për të ofruar një pastërti dhe qetësi në zonën e kompleksit memorial, ndërsa të konceptit të projektit me shifrën 1111 ato janë të koncentruar në afërsi të kompleksit. Projekti i prezantuar me shifrën 2606, përfshinë një zonë shumë më të gjerë të trajtimit se sa projekti me shifrën 1111, andaj i propozoj Panelit Shqyrtues që ankesa e OE me shifrën 1111, të refuzohet si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK”.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues dhe teknik, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues/teknik, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit ekonomik ankues, janë vlerësuar si të pa bazuara. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat, për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues.

Sa i përket pretendimit të parë ankimor Paneli shqyrtues ka vërejtur se zbulimi identitetit nga OE "Polis" është konfirmuar edhe nga vet autoriteti kontraktues përmes vendimit në kërkesës për rishqyrtim, ku autoriteti kontraktues e ka bërë të ditur se OE ka zbuluar identitetin. Megjithatë kthimi i lëndës në rivlerësim mbi këtë bazë, nuk do të sillte ndryshim në rezultat final për këtë aktivitet të prokurimit, kjo për faktin se OE ankues "Polis" nuk është i rekomanduar për kontratë. Sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 01.12.2023 operatori ekonomik i renditur me më shumti pikë është oferta me kodin 2606, ndërsa OE "Polis" është renditur i fundit. Prandaj kthimi i lëndës në rivlerësim vetëm do të shkaktonte vonesa dhe shpenzime shtesë pa ndryshim në rezultat final, andaj bazuar në këtë fakt të lartcekur pretendimi ankimor është vlerësuar i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të dytë ankimor Paneli shqyrtues ka gjetur se vlerësimi i projekteve është bërë nga një komision profesional pesë anëtarësh dhe një monitorues. Në kuadër të këtij komisioni ka pasur arkitekt nga MKRS dhe MMPHI, inxhinier i ndërtimtarisë dhe antropolog nga Universiteti i Prishtinës, arkitekt nga Asociacioni i Arkitekteve të Kosovës dhe zyrtar i prokurimit nga MKRS si monitorues i procesit të vlerësimit. Pas vlerësimit të projekteve të këtij konkurs projektimi, Juria profesionale nga AK, ka përzgjedhur projektin me shifrën 2606, është mjaft gjithëpërfshirës dhe integrues, duke inkorporuar brenda kompleksit faktorët natyror dhe njerëzor, peizazhin kulturor, përceptcionin e vizitorit, ndjenjën e krenarisë për të kaluarën, si dhe për avancimin kulturor në të ardhmen. Ndërsa sa i përket trajtimit të infrastrukturës fizike në projektet e prezantuara (terrenet sportive, rrugët dhe parkingjet) te projekti me shifrën 2606, janë vendosur ne periferi, për të ofruar një pastërti dhe qetësi ne zonën e kompleksit memorial, ndërsa te koncept projekti me shifrën 1111 ato janë te koncentruara në afërsi të kompleksit. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka gjetur se vlerësimi i jurisë në rastin konkret është vlerësim i drejtë ndërsa pretendimi ankimor është i pabazuar. Paneli pati parasysh edhe pohimin ankimor lidhur me ofertimin përmes e-prokurimit ndërsa pas verifikimit ne e-prkurim është vërejtur se asnjera nga ofertat pra përfshirë edhe ofertëne OE ankues nuk gjendet ne sisitemin e-prokurimi, andaj paneli kostaton se AK ka vepruar ne kuptim te nenit 7 të LPP-së ku trajtimi i të gjith ofertuesve nga ky aspekt është bërë mënyrë të barabartë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës përfshirë rekomandimin e komisionit profesional vlerësus, rekomandimet e të dy ekspertëve shqyrtues dhe teknik, dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm, ka gjetur se ankesa e Operatorit ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës, 01.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Zhvillimi i master - planit për Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz në Komunën e Skenderajt në

Republikën e Kosovës” numër të prokurimit 207-23-5283-2-1-1.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankesës së Operatorit ekonomik, vendos ti konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga OE ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën 1. dhe 2. të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën 3. të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - Instituti I Shkencës Dhe I Teknologjisë Insi SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: